



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

P/VENDIM

Nr. 02, dt. 10.03.2022

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA TE VITIT 2021 SHITESË NE BUXHETIN E KESHILLIT TE QARKUT 2022

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nen: 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.05.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2022, si dhe të akt rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit mbi përdorimin e fondeve të vitit 2021, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2021 në vlerë 16672107.67 lekë.
2. Të miratojë shtesë në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2022 të të ardhurave të trashëguara në vlerë 16672107.67 lekë.
3. Fondi prej 16672107.67 lekë do të përdoret në zërin “Investime”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrat e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHI

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Konceptoi E Qirinxhi

Juristi Gj. Kristo

Sekretar K.Qarkut B. Muco



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TË ARDHURAVE TË TRASHËGUARA TE VITIT 2021 SHITES NE BUXHETIN E KESHILLIT TE QARKUT 2022

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936 dt, 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2022” si dhe të Vendimit të Keshillit të Qarkut nr. 14 date 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut për vitin 2022” si dhe të akt rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit mbi përdorimin e fondeve për vitin 2021 dhe trashëgimin e tyre për vitin 2022, ju paraqitim për miratim përdorimin e të ardhurave të trashëguara nga viti 2021 si dhe miratimin e shteses në Buxhetin e vitit 2022.

Në bazë të akt rakordimit përfundimtar me Degën e Thesarit Korçë mbi përdorimin e fondeve të buxhetit të vitit 2021, Këshilli i Qarkut ka trashëguar fonde të përdorura në vlerë totale 64952593.67 leke. Trashëgimi i këtij fondi nga viti 2021 ka ardhur në disa zera të cilat janë analizuar në miratimin e buxhetit të vitit 2022. Rreth 40.14 % ose 26.07 milion leke janë trashëguar nga fondet e planifikuara për bashkefinancim për pjesëmarrje në projektet e Bashkimit Europian. Gjate vitit 2021 janë implementuar 5 projekte nga të cilat dy projekte janë mbyllur në fund të vitit. Tre projektet e tjera do të vazhdojnë gjatë vitit aktual, për të cilat është miratuar përdorimi i fondeve që në buxhetin fillestar. Diferenca fondesh të përdorura kemi edhe në zërin investime ku projektet me përfitues Bashkitë e Qarkut, janë prokuruar në vitin 2021 dhe përfundimi dhe financimi i tyre do të bëhet në vitin 2022. Në këtë zëri kemi trashëguar rreth 27.2 milion leke ose 41.9 % të trashëgimit në total. Objektet në proces janë mbuluar me fonde që në miratimin e buxhetit fillestar në muajin dhjetor.

Nga fondi i trashëguar në total prej 64952593.67 leke, fondi prej 48280486 leke është planifikuar për tu përdorur që në miratimin e buxhetit të vitit 2022. Pjesa e mbetur prej 16672107.67 leke propozojmë të përdoret e ndare si më poshtë:

- Në zërin Investime 16672107.67 leke

Ky fond do të përdoret në investime në përfitim të komunitetit të Rajonit tone dhe do të ndahet sipas projekt propozimeve nga ana e bashkive të qarkut dhe impaktit të tyre në komunitet.

Korçë me 02.03.2022

Edi Qirinxi
Drejtori i Financës